

REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlazine: Date / Dana: 03.10.12025		
Nr. Orgv Org. jed 01	Nr. Prot. Br. Prot. 01	Nr. Fageve. Br. Strana. 2



REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 01
Data: 27.12.2024

Në bazë të dispozitave të nenit 12, të Ligjit Nr. 03/L-040, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008), Rregullore (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe Rregullore (Qrk) Nr.06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (Qrk) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave lista I, shtojca II pika 8, dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2024 miratoi këtë:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E FUSHËS SË FOOTBALLIT NË FSHATIN TËRRN

I

Lokacioni për ndërtimin e fushës së Footballit në fshatin Tërrn caktohet në parcelën kadastrale 366-0 me sip. 4740 m², 1133-0 me sip. 910 m², 370-0 me sip. 3057 m² dhe 373-0 me sip. 97 m² dhe 316-0 me sip. 185 m² Z.K. Tërrn, pronë e Komunës së Ferizajt.

II

OBLIGOHET; Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis të lëshoj leje ndërtimore për ndërtim të fushës së Footballit në fshatin Tërrn

III

Ndërtimi dhe financimi për ndërtimin e fushës së Footballit në fshatin Tërrn do të bëhet nga banorët e fshatit.

IV

OBLIGOHET; Kryetari i Komunës që të lidhë marrëveshje të veçantë për përcaktimin e mënyrës së shfrytëzimit të këtij objekti me Kryetarin e fshatit Zaskok, ashtu siç e parasheh Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, neni 9 paragrafi 1, pika 1 deri 5.

V

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizimit, Mjedisit, dhe Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

VI

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi



REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlaze: Date / Dana: 03. 01. 2025		
Nr. Orgv Org. jed: 01	Nr. Prot. Br. Prot.: 02	Nr. Faqeve. Br. Strana: 1
Ferizaj - Uroševac		

REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 02
Data: 27.12.2024

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2024 miratoi këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2024-2027

I

Miratohet Plani i Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2027.

II

Pjesë përbërse e këtij vendimi është edhe dokumenti i detajuar i Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2027, i cili i ka kaluar të gjitha fazat ligjore.

III

Për realizimin e këtij vendimi do të përkujdeset Kuvendi i Komunës, Drejtoria e Financave Ferizaj si dhe Kryetari i Komunës së Ferizajt.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës





REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlazne: Date / Dana 03.10.2025		
Nr. Orgv Org. jed 01	Nr. Prot. Br. Prot. 03	Nr. Faqeve. Br. Strana. 2
Ferizaj - Uroševac		

REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 03
Data: 27.12.2024

Bazuar në neni 13 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme si dhe nenin 6 të Rregullores (QRK) Nr 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme, nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 te dates 28.06.2013. Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2024 miratoi këtë:

VENDIM

**PËR PLOTËSIMIN E LISTËS SË PRONAVE TË PUBLIKUARA SIPAS VENDIMIT ME NR. 01
NR. 105 TË DATËS 31.10.2025 PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM PËR VITIN 2025.**

I

Lista e veçantë e pronave për dhënie në shfrytëzim plotësohet me këto njësi Kadastrale;

Nr.	Numri i parcelës	Zona Katastrale	Titullari-Pronari	Sipërfaqja m ²	Qëllimi	Periudha kohore për dhënien në shfrytëzim
1	183-0 Objekti në këtë parcelë	Talinovc i Muhaxherëve	Komuna e Ferizajt	Caktohet pas matjes së objektit	Sipas destinimit me dokumente të planifikimit	Caktohet me vendim paraprak nga Kuvendi
2	400-0	Lloshkobare	Komuna e Ferizajt	7037	Sipas destinimit me dokumente të planifikimit	Caktohet me vendim paraprak nga Kuvendi
3	399-0	Lloshkobare	Komuna e Ferizajt	5598	Sipas destinimit me dokumente të planifikimit	Caktohet me vendim paraprak nga Kuvendi
4	349-0	Mirosale	Komuna e Ferizajt	4191	Sipas destinimit me dokumente të planifikimit	Caktohet me vendim paraprak nga Kuvendi
5	350-0	Mirosale	Komuna e Ferizajt	4131	Sipas destinimit me dokumente të planifikimit	Caktohet me vendim paraprak nga Kuvendi
6	2049-1	Ferizajt	Komuna e Ferizajt	Sip.caktohet pas matjeve ne teren	Sipas destinimit me dokumente të planifikimit	Caktohet me vendim paraprak nga Kuvendi
7	1842	Ferizajt	Komuna e Ferizajt	Sip.caktohet pas matjeve ne teren	Sipas destinimit me dokumente të planifikimit	Caktohet me vendim paraprak nga Kuvendi

II

Për realizimin e këtij vendimi do të përkujdeset Drejtoria për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër e Ferizajt si dhe Kuvendi i Komunës.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Xhavit Zariqi





REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA		
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlaze: Date / Dana: 03.04.2025		
Nr. Orgv Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 04	Nr. Faqeve. Br. Strana. 2
REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

**KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr. 04
Data: 27.12.2024**

Në bazë të dispozitave nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 te dates 28.06.2013, nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-139 me ndryshime dhe plotësime të Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, nenit 24. Parag.4 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, paragrafi 5 i nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr.09 /2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2024 miratoi:

VENDIM

PËR SHPALLJEN INTERES I PËRGJITHSHËM TË NGASTRAVE KADASTRALE; 275-3 Z.K. GËRLICË E ULËT PRONË PRIVATE, ME QËLLIM TË KËMBIMIT ME PJESËN E NGASTËRS KADASTRALE 275-2 Z.K. GËRLICË E ULËT, PRONË E KOMUNËS SË FERIZAJT.

I

Shpallen interes i përgjithshëm publik pjesët e ngastrës kadastrale:275-3 Z.K. Gërlicë e Ulët, me sipërfaqe prej 252 m², pronë e Haki (Muhamet) Selimi dhe Xhemile (Asan) Selimi.

II

Ngastrat kadastrale Shpallen Interes i Përgjithshëm-Publik dhe propozohen që të këmbehen me pjesen e ngastrës kadastrale 274-2 Z.K. Gërlicë e Ulët, sepse Komuna e Ferizajt në këtë parcelë ka implementuar projektin e zgjerimit të rrugës Varosh - Gërlicë e lidhet me magjistralen Ferizaj – Kaçanik.

III

Pronat të cilat shpallen interes i përgjithshëm – publik janë të regjistruara parcela 274-2 Z.K. Gërlicë e Ulët në pronësi të Komunës së Ferizajt, parcela 275-3 Z.K. Gërlicë e Ulët, është e regjistruar në emër të Haki (Muhamet) Selimi dhe Xhemile (Asan) Selimi në këtë parcela nuk ka ndonjë barrë apo kontest pronësor.

IV

OBLIGOHET; Kryetari i Komunës – Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që të kërkojë vlerësim të njësive kadastrale të përshkruara më lartë nga Ministria e Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë, dhe pas vlerësimit të njësive të sjell në Kuvend të Komunës Propozimin për Këmbim të këtyre njësive.

V

Ky vendim nuk ka titull ekzekutiv dhe i njëjti shërben vetëm për vlerësimin e paluejtshmërive.

VI

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës-Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlaze: Date / Dana: 03.01.2025		
Nr. Org. Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 05	Nr. Faqeve. Br. Strana. 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 05
Data: 27.12.2024

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale si dhe nenit 51 paragrafi 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2024 miratoi këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË KOMISIONIT TË DËMEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE.

I

MIRATOHET; Raporti i Komisionit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore i datës 21.11.2024, në vlerën totale prej 101,529.92€.

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është i bashkangjitur edhe raporti i detajuar i komisionit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore.

III

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Shërbimeve Emergjente në Komunën e Ferizajt si dhe Kuvendi i Komunës.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlaze: Date / Dana: 03/01/2025		
Nr. Orgv Org. jed: 01	Nr. Prot. Br. Prot.: 06	Nr. Faqeve: Br. Strana: 2
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 06
Data: 27.12.2024

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, nenit 14 paragrafi 1, nenit 15 paragrafi 2, nenit 16 paragrafi 1, Ligjit Nr.08/L-125 për Pronën Publike, Kuvendi i komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2024 miratoi këtë:

VENDIM

**PËR BARTJEN E PRONËSISË TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS- KOMPANISË
PUBLIKE OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.(KOSST).**

I

Barten në pronësi të Republikës së Kosovës - Kompanisë publike Operator Sistemi, Transmisioni dhe tregu SH.A (KOSST) me numër unik 811284512, me adresë në rrugë "Ilaz Kodra", Prishtinë, ngastrën kadastrale me Nr.103-0 Z.K.Sojevë me sipërfaqe prej 2.34h, pronë e Komunës së Ferizajt.

II

Qëllimi i bartjes së pronës në emër të Republikës së Kosovës është arritja e interesit publik, ndërtimi i sistemit BESS, projekt ky për ruajtjen e energjisë i financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës sipas marrëveshjes "Compact" e cila është ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës përmes Ligjit Nr.08/L-159.

III

Ngastra kadastrale e përshkruar më lartë bartet pa kompensim.

IV

Kuvendi i Komunës e autorizon Kryetarin e Komunës që brenda dhjetë (10) ditë pune nga hyrja në fuqi e vendimit të lidhë kontratë me Ministrinë e Ekonomisë dhe KOSST-in.

V

Për realizimin e këtij vendimi do të përkujdeset Drejtoria për pronë gjeodezi dhe kadastër si dhe që të bëjë operatin kadastral pas plotësimit të kushteve ligjore.

VI

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA

Datë / Izlaze: Date / Dana: 10.01.2025

Nr. Orgj. Org. jed.	Nr. Prot. Br. Prot.	Nr. Faqe. Br. Strana.
01	07	2

Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 07

Data: 27.12.2024

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit Nr.04/L-144 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008), nenit 24 të Ligjit Nr.06/L- 092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës 7 Mars 2019, neni 29 pika 1, Rregullores (Qrk) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2024 miratoi këtë:

VENDIM

PËR KËMBIMIN E PJESËS SË NGASTRËS KADASTRALE 1199-40, 1199-43, 1199-16, 1199-19, 1199-21, 1221-6, 1199-30, 1199-31 1059-3, 1059-6, 1059-5 DHE 1264-0 Z.K. PRELEZ I JERLIVE PRONË PRIVATE.

I

Këmbehen pjesët e ngastrave Kadastrale;

- 1199-40 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 2835 m², pronë e Egzon (Xhavit) Zymberi dhe Florentina (Nijazi) Zymberi Bytyqi.
- 1199-43 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 2664 m², pronë e Egzon (Xhavit) Zymberi dhe Florentina (Nijazi) Zymberi Bytyqi.
- 1199-16 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 33 m², pronë e Egzon (Xhavit) Zymberi dhe Florentina (Nijazi) Zymberi Bytyqi.
- 1199-19 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 36 m², pronë e Egzon (Xhavit) Zymberi dhe Florentina (Nijazi) Zymberi Bytyqi.
- 1199-21 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 99 m², pronë e Egzon (Xhavit) Zymberi dhe Florentina (Nijazi) Zymberi Bytyqi.
- 1221-6 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 99 m², pronë e Egzon (Xhavit) Zymberi dhe Florentina (Nijazi) Zymberi Bytyqi.
- 1199-30 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 99 m², pronë e Egzon (Xhavit) Zymberi dhe Florentina (Nijazi) Zymberi Bytyqi.
- 1199-31 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 99 m², pronë e Egzon (Xhavit) Zymberi dhe Florentina (Nijazi) Zymberi Bytyqi.

Me pjesën e ngastrës kadastrale 1064-1 Z.K. Prelez i Jerlive me sipërfaqe 11732 m², (1 he 17 ari e 32 m²)

Ngastra kadastrale;

- 1264-0 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 982 m², pronë e Blerim (Raif) Hyseni-Qirambajtje 99 vite.

Me pjesën e ngastrës Kadastrale 1064-1 Z.K. Prelez i Jerlive me sipërfaqe 982 m², dhe ngastra kadastrale;

- 1059-5 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 835 m², pronë e Blerim (Raif) Hyseni-Qirambajtje 99 vite.

Me pjesëne ngastrës kadastrale 1057-0 Z.K. Prelez i Jerlive me sipërfaqe 835 m².

II

Pronat të cilat propozohen të këmbehen janë të regjistruara në emër Egzon (Xhavit) Zymberi dhe Florentina (Nijazi) Zymberi Bytyqi si dhe Blerim (Raif) Hyseni-Qirambajtje 99 vite. Në këto parcela nuk ka ndonjë barrë apo kontest pronësor.

III

Pronat e përshkruara më lartë këmbehen me qëllim të organizimit – rregullim të parcelave, paraprakisht këto prona janë shpallur interes i përgjithshëm nga Kuvendi Komunal sipas Vendimit me Nr.01 Nr. 89 i datës 27.09.2024.

IV

Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruara më lartë, do të evidentohen në librat kadastral. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra komunale kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.

V

Për realizimin e këtij vendimi do të përkujdeset Drejtoria për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër në Ferizaj.

VI

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

